




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



 **REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. 841 Më 01.07 2019
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, neni 5 lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda territorit të Komunës së Rahovecit dhe që kanë përvojë në organizimin edhe mbarëvajtjen e festivaleve, të aplikojnë për organizimin e festave tradicionale kulturore në Komunën e Rahovecit, të cilat janë:

1. Festa e vjeljes së rrushit në Rahovec,
2. Agrofesta – në Krushë të Madhe,
3. Panairi i fundvitit për prodhime bujqësore në Rahovec.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për OJQ-të, të cilat veprojnë në Komunën e Rahovecit dhe të cilat kanë përvojë në organizimin e eventeve dhe festivaleve, të cilat kanë për qëllim promovimin e kulturës si dhe promovimin e produkteve bujqësore:

1. Festa e vjeljes së rrushit - në kuadër të së cilës bëjnë pjesë:
 - Promovimi i hardhisë së rrushit,
 - Promovimi i prodhimeve të rrushit,
 - Promovimi i kulturës dhe artit të Komunës së Rahovecit,
 - Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovimin e vlerave kulturore,
 - Aktivitetet tradicionale kulturore,
 - Promovimi i vlerave artizanale të Komunës së Rahovecit,
 - Promovimi dhe ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike,
2. Agrofesta - në kuadër të së cilës bëjnë pjesë:
 - Promovimi i produkteve bujqësore,
 - Promovimi i farërave të produkteve bujqësore,
 - Promovimi i kulturës së bujqëve,
 - Promovimi i prodhimeve të produkteve bujqësore,

3. Panairi i fundvitit për prodhime bujqësore në kuadër të së cilës bëjnë pjesë:
- Promovimi i produkteve bujqësore,
 - Promovimi i prodhimeve bujqësore,
 - Promovimi dhe ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike.
 - Promovimi i vlerave artizanale.
 - Aktivitete tradicionale kulturore.

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 23,000.00 Euro

Specifikat tjera të thirrjes publike

- **Thirrja publike për aplikim hapet më 01.07.2019 dhe mbyllet më 15.07.2019.**
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DBPZHR.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit,
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar nga OJQ,
- Certifikata me numër fiskal,
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit,
- Kopja e kartelës së xhirollogaroisë në emrin e OJQ-së dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar,
- Raporti financiar i vitit paraprak 2018,
- Dëshmia se ka përvojë në realizimin e projekteve duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën.

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit origjinal të kërkuara si dhe kopja elektronike në CD,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimi në katin e parë në objektin e Komunës.

